

VENDIM
Nr. 226, datë 9.4.2012

**PËR RISHPËRNDARJE NË NUMRIN E PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE
BUXHETORE, MIRATUAR PËR VITIN 2012, NGA SHËRBIMI INFORMATIV I
SHTETIT TE MINISTRIA E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të shkronjës "a", të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve, miratuar për vitin 2012, të bëhet rishpërndarja, si më poshtë vijon:

- a) Ministrisë së Mbrojtjes t'i shtohen 7 punonjës për funksionimin e Drejtorisë së Shifrës, si autoriteti kombëtar për sigurimin e komunikimeve dhe autoriteti kombëtar i shpërndarjes, në varësi të kësaj ministrie;
- b) Shërbimit Informativ të Shtetit t'i pakësohen 7 punonjës.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2012 të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

- a) Shërbimit Informativ të Shtetit në programin me kod 03520 "Veprimtaria informative shtetërore" t'i pakësohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, nga i cili: shpenzime korente 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë dhe shpenzime kapitale 400 000 (katërqind mijë) lekë;
- b) Ministrisë së Mbrojtjes në programin me kod 01110 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi" t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, nga i cili: shpenzime korente 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë dhe shpenzime kapitale 400 000 (katërqind mijë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha